

ETIKA DHE GAZETARIA NË SHQIPËRI

Në Shqipëri, gazetarët e intervistuar në kuadrin e këtij sondazhi sollën një pamje pothuajse të unifikuar të problemeve etike me të cilat përballet gazetaria në vend. Ndërhyrja e redaktorëve dhe sidomos e pronarëve, nënshtrimi ndaj interesave të tyre ekonomike dhe politike, situata e pakënaqshme materiale, shfrytëzimi i pushtetit mediatik për përfitime ekonomike dhe politike, si dhe një presion i madh për vetëcensurë përbëjnë aspektet më problematike të cilat identifikojnë gazetarët. Nga ana tjetër, kur i bashkohen mungesës së përvojës profesionale ose pakujdesisë së vetë gazetarëve, konsideratës së pamjaftueshme për të drejtat e njeriut gjatë gjetisë për sensacionalizëm, si dhe brishtësisë së gazetarëve përballë përfitimeve materiale, gjendja etike e gazetarisë në Shqipëri, megjithë përmirësimet e ngadalta, duket se ka ende rrugë për të bërë drejt standarteve të kënaqshme.

Gjatë këtij sondazhi të intervistuarit përfshinin përfaqësues nga 30 media kryesore në vend. Për shkak të natyrës së veçantë të peizazhit të medias shqiptare, këto intervista u përqendruan vetëm në mediat e vendosura në Tiranë, duke pasur parasysh ndikimin relativisht të papërfillshëm të mediave jashtë Tirane. Të intervistuarit që u përzgjedhën ishin kryesisht redaktorë dhe gazetarë që mbulonin çështjet politike, sociale dhe ekonomike. Gazetat e përditshme të cilat u përfaqësuan në këtë sondazh ishin: Shekulli, Korrieri, Panorama, Gazeta Shqiptare, Tema, Koha Jonë, Metropol, Albania, Ballkan, Biznes, dhe Sot. Përveç këtyre, pjesë e studimit ishin dhe revistat e përjavshme kryesore: Klan, Spektër, dhe Monitor. Përsa u përket radiove, pjesëmarrësit ishin nga: Radio Tirana, Top Albania Radio, +2 radio, Radio Rash, dhe Radio Alsat. Gazetarët dhe redaktorët e stacioneve televizive ishin nga mediat në vijim: TVSH, TVA, TV Klan, Top Channel TV, Vizion + TV, TV Koha, News 24 TV, Telenorba Shqiptare, Shijak TV, dhe Alsat TV. Gjithashtu u përfshi dhe një gazetar nga Agjencia Telegrafike Shqiptare.¹

Përgjigjet e intervistave të zgjeruara tregojnë se shumica e gazetarëve që pasqyrojnë ngjarjet apo individët politikë, ose institucionet qeveritare përballen me disa detyrime të tjera përveç atyre që imponojnë etika dhe profesionalizmi. Këto detyrime variojnë që nga “këshilla” nga redaktorët ose pronarët e medias për mënyrën se si të pasqyrojnë një temë të caktuar, deri në direktiva të qarta se si të mbulojnë pozitivisht ose negativisht disa institucione qeveritare, politikanë, apo ngjarje. Shumë prej tyre bëjnë të ditur për raste konkrete kur u urdhëruan

¹ Është më vend të përmendet se një prirej që u vu re gjatë intervistave ishin përgjigjet e shkurtra të gazetarëve dhe dëshira relativisht e dobët për të dhënë përgjigje të gjata dhe shembuj konkretë për secilën prej pyetjeve. Megjithatë, duke pasur parasysh kohën kur u zhvillua studimi, kjo gjë nuk duhet të na habisë: sondazhi rastisi në të njëjtën kohë që u zhvillua dhe fushata e zgjedhjeve parlamentare 2005. Këto zgjedhje u vlerësuan jashtëzakonisht të rëndësishme dhe gjetën pasqyrimin më të zgjeruar nga media deri në këtë periudhë; për pasojë gazetarët ishin nën trysinë e kohës më shumë se çdo herë tjetër.

nga pronari i medias apo redaktori të mos shkruanin më për një temë të caktuar politike, pa iu dhënë justifikime apo arsyetime për këtë. Në shumë përgjigje të dhëna gazetarët gjithashtu pretendojnë se në disa raste disa shkrime nuk botohen pasi ato prekin interesa të posaçme biznesi apo politike. Rezultati përfundimtar i detyrimeve politike, ekonomike apo të ndonjë lloji tjetër duket se është një gazetar që i nënshtrohet politikave të gazetës, nis të mbajë përbrenda dhe t'i duken të natyrshme presionet të cilave iu nënshtrohet, duke zhvilluar në këtë mënyrë atë që disa nga të intervistuarit e quajtën “vetëcensurë,” ose ndryshe procesin me anë të të cilit gazetarët përpiqen të marrin me mend atë që pronari i medias dëshiron të dëgjojë dhe atë që është më pranë preferencave dhe interesave të tij. Ndërkohë që kjo gjë e bën më të lehtë jetën e gazetarëve, ajo nuk ndikon për mirë në pasqyrimin objektiv dhe të saktë të ngjarjeve politike.

Në këtë pikë është e rëndësishme të shqyrtojmë se si gazetarët e përshkruajnë ndërhyrjen në punën e tyre, e cila është burimi i një procesi afatgjatë që në fund sjell vetëcensurën. Deri tani shumica e gazetarëve të intervistuar thonë se direktivat politike dhe ekonomike e dhëna nga pronarët ose redaktorët e medias ndikojnë natyrën e pasqyrimin nga ta. Këto udhëzime variojnë nga urdhra të drejtpërdrejta për atë çka duhet dhe nuk duhet botuar deri në presione të drejtpërdrejta për mënyrën si duhen mbuluar çështje specifike. Ata kanë për qëllim të bëjnë një pasqyrim që nxit në mënyrën më të mirë interesat e ngushta të pronarëve, ose një pasqyrim të favorshëm të institucioneve qeveritare, politikanëve ose individëve të tjerë, i cili mund të sjellë një nxitje të këtyre interesave. Sipas një gazetari kjo është një dukuri që “pak a shumë ndodh në gjithë median shqiptare, përfshirë atë ku punoj unë. Do të thoja se udhëzimet në lidhje me tema ekonomike ndikojnë në punën time më tepër, edhe pse ka dhe raste kur këto udhëzime lidhen me çështje politike. Kjo ndodh për shkak se media zotërohet nga sipërmarrës, interesat e të cilëve shpesh janë të lidhura me interesat e qeverisë”.

Një gazetar tjetër thotë: “Jam në dijeni të rasteve kur lajme të cilat mund të dëmtojnë investimet apo interesat e njerëzve të cilët mbështesin grupin mediatik nuk janë botuar fare.” Kjo deklaratë mbështetet nga reagime të tjera në të cilat gazetarët sjellin shembuj konkretë kur puna e tyre nuk është botuar në mënyrë që të shmangej armiqësia me disa institucione, të cilat nga ana e tyre do të garantonin interesat e pronarit të medias.

Ndërsa në disa raste disa artikuj nuk ishin botuar për shkak të udhëzimeve ekonomike dhe politike të cilat priren të ruajnë interesat e pronësisë së medias, në raste të tjera gazetarëve u ishte kërkuar të shkruajnë artikuj ose të bënin një pasqyrim që do të nxiste drejtpërdrejt këto interesa. Kështu, një gazetar thotë se në dy-tre raste i ishte dashur të shkruante artikuj sipas porosive të pronarit. “Personalisht nuk më pëlqeu asnjëherë kjo gjë dhe kur shkruajta duke ndjekur udhëzimet e pronarit nuk e vura emrin në fund të artikullit.”

Këto ndikime tregojnë se pronarët shpesh e përdorin median për të nxitur interesat e tyre. Kjo gjë bëhet edhe më e dukshme gjatë fushatave zgjedhore, kur pronarët e medias përkrahin jo vetëm parti të caktuara, por edhe politikanë të caktuar. Kështu, një gazetarë thotë se gjatë një fushate zgjedhore “iu kërkua të shkruante një artikull pozitiv për një politikan që po kandidonte. Kjo ndodh dhe në media të tjera. Pavarësia e medias në Shqipëri është relative dhe shembuj të tillë ekzistojnë.” Në një mënyrë të ngjashme, gazetarë të tjerë bëjnë të ditur se iu është kërkuar të bëjnë një pasqyrim pozitiv të veprimtarive të biznesit që ose janë të pronarëve të medias, ose përdoren për t’i mbështetur këta të fundit. Ka raste të qarta në të cilat media përdoret drejtpërdrejt për disa qëllime konkrete.

Megjithatë, shumë gazetarë pretendojnë se ndikimi i pronësisë së medias është bërë gjithnjë e më i sofistikuar dhe nuk është më aq i dukshëm dhe i drejtpërdrejtë si në vitet e mëparshme. Tashmë në shumë media ndikimi shfaqet më shumë i tërthortë dhe më tepër në formën e këshillave dhe sugjerimeve për mënyrën se si një ngjarje e caktuar duhet të pasqyrohet më tepër se në formën e një presioni real ose urdhrash për atë çka duhet shkruar dhe si duhet shkruar. Kështu, sipas gazetarit “direktivat politike dhe ekonomike ndikojnë pasqyrimin në median shqiptare në një mënyrë jo aq të dukshme. Rastet kur pronari apo kryeredaktori i jep formë të drejtpërdrejtë pasqyrimin ose e censuron atë po bëhen gjithnjë e më të rralla.” Një sërë gazetarësh të tjerë ishin të të njëjtit mendim, duke thënë se ndikimi tani ushtrohet në një rrugë më të tërthortë.

Të gjitha përgjigjet, si dhe shembujt e mësipërm, dëshmojnë se ekziston një ndikim i drejtpërdrejtë i pronarëve në pasqyrimin mediatik, i cili nga ana e vet ka një ndikim të drejtpërdrejtë në kufizimin e pavarësisë editoriale në media. Kjo dukuri shfaqet dhe në përgjigjen e një kryeredaktori, i cili pretendon se “si kryeredaktor unë jam ai që u jep udhëzime gazetarëve. Duhet të them se 80 % e udhëzimeve janë të miat dhe ato pasqyrojnë idenë time si duhet të bëhet pasqyrimi, ndërsa rreth 20% e udhëzimeve rrjedhin nga ndikimi i pronarëve.” Megjithëse këto përqindje nuk mund të jenë tërësisht të sakta, ato tregojnë se pronësia e medias ushtron një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të përditshëm në pasqyrimin mediatik, në vend që të krijojë një orientim politikash afatgjatë me median, duke kufizuar në këtë mënyrë pavarësinë editoriale.

Megjithatë, është e rëndësishme të përmendet se jo të gjitha udhëzimet që u jepen gazetarëve kanë për qëllim të nxisin interesa të caktuara politike apo ekonomike. Shpesh ato janë thjesht pjesë e politikës editoriale të një media. Shumë gazetarë e quajnë këtë “qasje” të medias dhe mendojnë se gazetarët që punojnë për gazetën duhet ta pranojnë dhe përqafojnë këtë qasje si pjesë të politikës editoriale të gazetës. Megjithatë, mbetet e paqartë se çfarë nënkupton ky term dhe deri në çfarë mase qasja e një media të caktuar përcaktohet nga politika e saj editoriale duke u nisur nga parimet dhe vlerat që ka një media dhe në çfarë mase politika editoriale është thjesht një emërtim tjetër për qasje të maskuara që kanë për qëllim thjesht të ruajnë dhe rrisin interesat ekonomike të pronarëve të medias. Mbetet fakt se në shumë raste gazetarët kanë shprehur

mospëlqimin e tyre në mediat ku punojnë. Pothuajse në të gjitha rastet pikëpamjet e tyre nuk janë marrë parasysh dhe politika është vendosur nga vetë pronari.

Përveç ndikimeve dhe udhëzimeve që vijnë nga pronësia e medias ose nga redaktorët, ka dhe ndikime dhe presione që vijnë nga grupe jashtë fushës së medias, edhe pse ndikimi i tyre mund të ushtrohet vetëm nëpërmjet pronësisë së medias.

“Ka raste të tilla si në median pu punoj, ashtu dhe në media të tjera. Në shumicën e rasteve ndërhyrje të tilla vijnë nga skena politike, edhe pse në disa raste vijnë edhe nga bizneset, shumicën e kohës në një mënyrë të tërthortë, duke kërkuar një nder, i cili do të shpërblehet në të ardhmen.” Një sërë shembujsh u dhanë nga gazetarët kur pas ndërhyrjes së institucioneve shtetërore apo individëve, atyre u është thënë ose të mos shkruajnë më për një temë konkrete ose që të mos e mbulojnë më fare këtë fushë. Në shumicën e rasteve gazetarët thonë se palët e interesuara kontaktojnë pronarët ose drejtorët e medias, të cilët janë në gjendje të garantojnë se gazetarët do t’u binden kërkesave të tyre. Në një rast të tillë një gazetarë investigative, e cila kishte shkruar për fondin e pensioneve dhe disa vështirësi që qytetarët kishin me skemat e pensioneve, i ishte kërkuar të mos shkruante më për këtë gjë, pa ndonjë shpjegim, sidomos po të kihej parasysh që kjo gjë lidhej me interesin e shumë qytetarëve. Në raste të tjera gazetarëve u ishte kërkuar të pasqyronin një temë të posaçme në një këndvështrim pozitiv. Në të gjitha këto raste, të cilat duket se janë më shumë ndërhyrje nga aktorë politikë për të ndërprerë botimin e një artikulli apo një pasqyrim të caktuar, palët e interesuara “kërkojnë një nder” nga media, të cilin ata do e shpërblejnë më tej.

Një ndërhyrje e tillë e bën më të lehtë edhe lidhja e ngushtë mes medias dhe biznesit nga njëra anë dhe medias dhe politikës nga ana tjetër. Në disa raste është e vështirë të caktosh kufirin mes tyre, pasi një pronar media mund të jetë dhe politikan, edhe biznesmen në të njëjtën kohë. Megjithatë, edhe atëherë kur dallimi është i qartë, ekzistojnë lidhje të afërta personale. Në shumë raste pronarët dhe drejtorët e medias kanë lidhje të afërta personale me individë politikë dhe publikë, gjë që e bën akoma më të lehtë mundësimin e “ndereve mediatike.” Kështu, sipas një gazetari “kur vjen puna te temat delikate pronarët e medias ushtrojnë njëfarë presioni. Kjo vjen edhe për shkak të ambientit shqiptar, ku njohjet personale janë shumë të rëndësishme dhe të kudondodhura.”

Lidhja e ngushtë midis medias dhe politikanëve nuk gjendet vetëm në nivelin e pronësisë së medias. Shumë gazetarë, sidomos ata me më shumë përvojë, bëjnë të ditur për lidhje të ngushta dhe miqësi me politikanë të rangut të lartë apo me ministra. Media shqiptare dhe skena politike në fund të fundit është aq e vogël sa e bën shumë të lehtë që pjesëmarrësit ta njohin njëri-tjetrin nga afër. Një gazetar me përvojë tha: “Unë kam miq të cilët janë ministra apo politikanë dhe unë kam pasur biseda jo formale me ta jashtë orarit të punës, nëpërmjet të

cilave mund të kem ndikuar te ata si individë, dhe me më pak mundësi te partitë të cilat ata përfaqësojnë.” Përgjigje të tjera dëshmojnë për të njëjtën gjë: shumë gazetarë, sidomos ata me më shumë përvojë dhe që janë më të njohur, kanë lidhje të drejtpërdrejta dhe të afërta me politikanët. Kjo pasqyrohet gjithashtu nga fakti se disa gazetarë thanë se ata kanë ndërmjetësuar midis politikanëve në disa raste delikate. Gazetarë të tjerë, më të rinj, të cilët nuk kishin patur vetë këto përvoja, kishin dëgjuar për raste të tilla.

Natyrisht që lidhje të tilla të ngushta midis medias dhe politikës mund të kenë një sërë pasojash serioze përsa i përket cilësisë dhe saktësisë së pasqyrimin të ngjarjeve politike nga media. Në bashkëpunim me faktorë të tjerë, si interesat ekonomike dhe ato politike, kjo mund të shpjegojë se pse disa media kanë pasqyrim pozitiv për disa politikanë dhe pse jo për disa të tjerë. Në të njëjtën kohë, ajo gjithashtu mund të shpjegojë pse miqësira apo lidhje të tilla joformale dhe sulmet mediatike priren të jenë personale dhe jo të lidhura me tema të ndryshme. Në fakt, si bëjnë të ditur shumë gazetarë, mjaft shpesh artikujt dhe raportet mediatikë sulmojnë drejtpërdrejt individët dhe jo vetë çështjet në fjalë. Këto sulme në shtypin shqiptar priren të jenë të hidhura dhe personale.

Përkrah miqësisë, lidhjet mes medias dhe politikës duket se fuqizohen dhe nga nevoja për të punuar së bashku. Shumë gazetarë duket se përfshihen edhe në dhënie këshillash apo konsulence për institucionet publike, të paktën në mënyrë informale. Një nga gazetarët e intervistuar thotë se “ në mënyrë informale ka dhënë konsulencë për institucionet publike. Raste të tilla dihet se ndodhin për shkak të lidhjeve të ngushta midis ambientit mediatik nga njëra anë dhe skenës politike dhe institucioneve publike nga ana tjetër.” Në një rast ekstrem një gazetar punonte në të njëjtën kohë si zëdhënës për një ministër qeverie dhe si gazetar në një stacion televiziv privat kombëtar. Ai tha se e kishte përdorur pozicionin e tij në ministri në mënyrë që të merrte dhe botonte informacion. Në fakt, shumica e gazetarëve të intervistuar u ankuan se shumë shpesh i njëjti person punonte si zëdhënës në një institucion publik dhe si gazetar në një media, duke shfrytëzuar kështu pozicionin e tij në mënyrë të padrejtë. Është e vështirë të përcaktohet sa të shpeshta janë raste të tilla, megjithatë ato ekzistojnë.

Në këtë pikë është e rëndësishme të shqyrtojmë pasojat e ndërthurjes së ndërlikuar midis interesave të pronësisë së medias nga njëra anë dhe politikës nga ana tjetër, mbi gazetarët, ashtu si pasqyrojnë përgjigjet e tyre. Ky ndikim sjell një politikë editoriale, e cila shpesh mund të jetë kundër bindjeve të vetë gazetarëve, ose një mungesë të saj. Në fakt, si bëjnë të ditur ata, në disa raste ata nuk bien dakord me qëndrimin politik të medias së tyre. Megjithatë, sipas një gazetari të intervistuar “në përgjithësi gazetarët e thjeshtë i binden qasjes politike dhe ideologjike të medias në të cilën punojnë. Kryesisht kjo ndodh në mënyrë që ata të ruajnë vendin e tyre të punës, por edhe për shkak të një vetëcensure që ata zhvillojnë.” Disa thonë se mënyra me anë të së cilës ata mund të mposhtin mospërputhjen mes asaj që ata besojnë dhe qëndrimin të medias së tyre është

duke raportuar me objektivitet dhe paanshmëri. Shumë të tjerë përgjigjen se ata përpiqen t'i përshtaten politikës editoriale të medias ku punojnë. Si e vuri në dukje një gazetar: “nëse një gazetar nuk gjen një ambient të përshtatshëm me besimet e tij apo të saj, në një botë ideale duhej të ndërronte punë dhe të shkonte në një media tjetër; por në botën reale kjo nuk është e lehtë dhe shpesh njerëzit janë të detyruar të bëjnë kompromise.” Kjo është e kuptueshme nëse marrim parasysh që shumica e gazetarëve raportojnë se ata me zor mund të mbulojnë jetesën e tyre nëpërmjet gazetarisë. Shumica e tyre thanë se ata nuk mund ta përballonin jetesën vetëm me anë të gazetarisë dhe pa pasur mbështetjen e familjeve të tyre. Kështu, për shumë prej tyre, sidomos për ata më të rinjtë, ruajtja e punës është shumë e rëndësishme, gjë që i detyron ata të bëjnë kompromise dhe të mos mbrojnë bindjet e tyre.

Është pikërisht në kryqëzimin e faktorëve të mësipërm ku shfaqet dukuria e vetëcensurës. Ndikimet dhe udhëzimet nga brenda medias, presionet e jashtme dhe nderet nga institucionet politike apo individës, së bashku me varësinë financiare në një treg pune të pasigurtë shpjegojnë se pse dhe si lind vetëcensura. Vetëcensura është një vegël mjaft e dobishme, e cila e bën jetën e gazetarit më të lehtë në përballje me interesa të shumta politike dhe ekonomike. Rasti më domethënës ishte ai i një gazetares të re, e cila tha se pronari i medias i kishte kërkuar drejtpërdrejt të nxiste interesat e tij nëpërmjet shkrimeve në media. Ajo tha: “Unë vetë nuk jam e çliruar nga ndonjë lloj vetëcensure dhe ndoshta në mënyrë të paqëllimshme në shkrimet e mia pasqyroj pozitivisht ato rryma apo individë politikë të cilët mund të jenë të lidhur me pronarin tonë.” Ky rrëfim është mjaft domethënës dhe i thellë. Në median shqiptare në përgjithësi të gjithë punonjësit janë të mirëinformuar në lidhje me interesat politike dhe ekonomike të pronarëve të medias, dhe kjo në vetvete mund të jetë e mjaftueshme për të ndikuar mbulimin mediatik, sidomos për ata u përket gazetarëve të rinj dhe të pasigurtë. Shembulli i mësipërm është gjithashtu domethënës pasi sillet nga dikush që është i ndërgjegjshëm për dukurinë e vetëcensurës. Gazetarë të tjerë të cilët mund të jenë prekur nga e njëjta sindromë mund edhe të mos jenë fare të ndërgjegjshëm për vetëcensurën e tyre ose nuk duan ta pranojnë atë. Pra, nuk është e përjashtueshme që një dukuri të tillë të mos i jetë dhënë roli i duhur dhe në fakt ajo është shumë më e përhapur se sa duket për momentin.

Një nga pasojat e para dhe më të dukshme të vetëcensurës është se ajo e bën shumë të vështirë të vlerësosh pasqyrimin mediatik për ata i përket zhvillimeve politike. Kjo nuk do të thotë se vetëcensura nuk shtrembëron apo kufizon pasqyrimin mediatik të ngjarjeve politike, por thjesht që është e vështirë të përcaktohet masa që arrin kjo dukuri. Si e vuri në dukje dhe një nga gazetarët e intervistuar: “më tepër se mungesa e lirisë për të shprehur opinionin tënd, problemi i medias shqiptare është se ka një lloj vetëcensure që e bën të vështirë që gazetarët të shprehin mendimet e veta.” Në të njëjtën mënyrë, një gazetar tjetër tha se “një nga arsyet pse gazetarët mund të mos jenë të lirë të shprehin mendimet e tyre është për shkak të një lloj vetëcensure”.

Një pasojë tjetër shumë problematike e sindromës së vetëcensurës është krijimi i një rrethi vicioz të joprofesionalizmit. Duke pasur parasysh mënyrën e funksionimit të medias shqiptare, vetëcensura është një veti më tepër se një ves për t'u dënuar, si për pronarët e medias, ashtu dhe për qeverinë dhe institucionet politike. Vetëcensura ka më tepër të ngjarë të zhvillohet te gazetarët e rinj, të sapopunësuar dhe më pak te gazetarët e njohur me më shumë integritet profesional. Në fakt, si e konfirmojnë dhe gazetarët në përgjigjet e tyre, gazetarët e njohur, me famë në media, kanë më tepër mundësi të bëjnë të ditur mendimet e tyre dhe ka të ngjarë të kenë më pak presion nga faktorë të brendshëm të medias ose të jashtëm, si janë institucionet qeveritare. Kësisoj, në një peizazh ku roli i medias si një instrument për të garantuar informacion të saktë i nënshtrohet ruajtjes së interesave të pronarit, gazetarët profesionistë dhe me integritet përbëjnë më tepër një kërcënim sesa një virtyt, ndryshe nga gazetarët e rinj dhe të pasigurtë, të cilët mund të përdoren më me lehtësi për qëllime të ndryshme, të cilat për nga ana e standarteve gazetareske mund të cilësohen si joetike, si shkrimi i artikujve me emra të tjerë.

Kjo gjë mund të shpjegojë qasje problematike dhe joprofesioniste ndaj raportimit. Duke pasur parasysh motivimet të cilave u përgjigjet media, nivelet e larta të profesionalizmit dhe etikës nuk përbëjnë qëllimin kryesor. Kështu, midis të intervistuarve ishte vështirë të gjendeshin raste ku gazetarët shkruanin një përgënjeshttrim pasi kishin marrë dhe botuar informacion të pasaktë nga burimet e tyre. Sipas një gazetari “ekzistojnë shumë raste kur informacioni i pasaktë botohet në gazetë, por rrallë ndodh që këto raste të përgënjeshtrohen.” Një gazetar tjetër, pasi kish pranuar që kishte botuar informacion të pasaktë, tha se ai “nuk botoi një përgënjeshttrim, pasi informacioni ishte i pasaktë, jo i gabuar. Unë e informova publikun mbi këtë temë nëpërmjet mjeteve të tërthorta.” Mbetet e paqartë se çfarë nënkupton me saktësi gazetari këtu, por diçka mund të konkludohet me siguri: ai nuk e informoi qartë lexuesin për “informacionin e pasaktë, i cili nuk ishte i gabuar.” Në një mënyrë të ngjashme, një gazetar tjetër tha se kur boton informacion të pasaktë, ai “nuk shkruan një përgënjeshttrim, por me anë të mjeteve gazetareske, përpiqet ta ndreqë informacionin me sa mundet”. Përsëri është e paqartë se pse nuk botohet përgënjeshttrim për informacionin e pasaktë dhe në këtë mënyrë të informohet lexuesi. Është e qartë, si konfirmohet nga pothuajse çdo i intervistuar, që rastet kur korrigjimet apo përgënjeshttrimet botohen janë shumë të rralla në median shqiptare. Me fjalë të tjera, jo vetëm që niveli i profesionalizmit është i ulët në këtë aspekt, po duke pasur parasysh mënyrën se si funksionon media shqiptare, duket se ka shumë pak motivim për të ndryshuar situatën. Si u përmend më sipër, roli i medias si një burim informacioni i është nënshtuar deri në njëfarë mase rolit të saj si një mjet që ruan dhe nxit disa interesa të ngushta. Një skenar ky ku vetëcensura nga ana e gazetarëve bëhet më i vlefshëm se profesionalizmi.

Si tregon dhe analiza dhe informacioni i mësipërm, gazetarët që mbulojnë politikën përballen me disa sforcime në raportimin dhe analizën e tyre.

Megjithatë, analiza e mësipërme duhet parë me rezervë, pasi gjendja ndryshon mjaft nga njëra media në tjetrën dhe çdo përpjekje për përgjithësim është e destinuar të bëjë një përfaqësim të gabuar të skenës mediatike. Kishte shumë gazetarë të cilët nuk ndienin ndonjë lloj presioni ose nuk ndiheshin të përdorur nga pronarët apo redaktorët e medias së tyre. Në këtë mënyrë, do të ishte e gabuar që nga analiza e mësipërme të arrihet në përfundimin që nuk ka liri të medias në Shqipëri. Analiza e mësipërme dhe përgjigjet për intervistat e zgjeruara me gazetarët thjesht tregojnë për disa vështirësi me të cilat përballet pasqyrimi mediatik i politikës. Madje edhe në këto vështirësi ka liri, sidomos duke pasur parasysh numrin e madh në rritje të mediave, të cilat përbëjnë një mundësi për larmi në këndvështrimet e ndryshme që ato sjellin, si dhe një sfidë për besueshmërinë, duke pasur parasysh se sa larg njëri tjetrit këto këndvështrime janë ndonjëherë.

Të pyetur për përdorimin e burimeve anonime ose të pakonfirmuara në punën e tyre, shumica e gazetarëve e distancuan veten nga kjo praktikë por shumë shpejt treguan se kjo gjë ndodh në media të tjera. Disa gazetarë thanë se ekziston një epidemi e “burimeve të pakonfirmuara” ose e “kanë dalë fjalë që,” e cila shfaqet sidomos në raste krize qeveritare apo ndryshimesh të mundshme të kabinetit. Vështirësia në këtë rast qëndron sidomos në mungesën e vullnetit nga ana e politikanëve për t’u prononcuar. Një arsye tjetër për dukurinë e burimeve të pakonfirmuara ishte dhe ritmi i punës, i cili i nxiste gazetarët të dorëzonin punën në kohë dhe jo të kishin parasysh konsideratat etike. Megjithatë, disa gazetarë e lidhën këtë me mungesën e përvojës në gazetari: “Vite më parë botoja artikuj të cilët përmbanin ‘burime të pakonfirmuara’, pasi nuk kisha përvojën e punës dhe kontaktet e nevojshme.” Gazetaria shqiptare përfiton nga vitaliteti i gazetarëve të rinj dhe në të njëjtën kohë vuan mungesën e tyre të përvojës: studentët e gazetarisë, të cilët nisin të punojnë në media që në vit të parë janë mjaft të përhapur. Kjo dukuri pasuron burimet e tyre financiare dhe përvojën dhe në të njëjtën kohë ul kostot e pronarëve të medias së tyre.

Një tjetër pyetje që iu bë gazetarëve ishte nëse mbanin mend ndonjë rast kur ishte e qartë që i intervistuari po gënjente. Pothuajse gjithmonë rastet e sjella ishin ato të intervistave me politikanë, sidomos gjatë fushatave zgjedhore. “Kjo është një gjë që ndodh në intervista me udhëheqës politikë, pasi ata përpiqen t’u shmangen pyetjeve gjithë kohën.” Megjithatë, gazetarët televizivë duket se janë më të prekur në këtë aspekt, duke pasur parasysh mbizotërimin e pasqyrimin televiziv të debateve politike. Vetëm pak prej tyre thanë se kishin ngulur këmbë në pyetjet e tyre ose kishin mbuluar ngjarjen duke shtuar burime të tjera informacioni. “Kur e ndjeja që po i shmangeshin pyetjes kam këmbëngulur derisa i kam mërzitur derisa merrja një përgjigje. Kjo ndodhte shpesh sidomos me zyrtarët e qeverisë.” Përsëri, përvoja duket se është një faktor tjetër për t’u marrë parasysh, pasi gazetarët me më shumë përvojë dukej se ishin më këmbëngulës në zbulimin e të vërtetës në intervistat e tyre, ose të paktën në pyetjet e tyre.

Nga ana tjetër, përvoja nuk duket se ka ndonjë ndikim të veçantë në botimin e artikujve apo transmetimin e kronikave që prekin persona të caktuar. Ashtu si pritej, pothuajse të gjithë personat e intervistuar thanë se shpesh kishin parë histori të tilla në mediat ku punojnë. Këto thënie treguan një prire interesante: mesa duket ndodh më shpesh që personat e prekur nga pasqyrimi mediatik janë figura publike, pothuajse gjithnjë politikanë të rangut të lartë. “Nuk ka patur raste të sulmimit të qëllimshëm të figurave jopublike nga media. Zakonisht iu ndodh personave që drejtojnë institucione publike që të bëhen objekt i këtyre artikujve.” Për shembull, në këtë kontekst, shumë të intervistuar kur iu përgjigjën pyetjes treguan për rastin specifik të artikujve “ngacmues” të përqendruar te gruaja e kryeministrit. Megjithëse disa nga gazetarët dukej se e justifikonin këtë prirje deri në njëfarë mase duke pasur parasysh statusin publik të këtyre figurave dhe të drejtën e publikut për të ditur, shumë prej tyre nuk e miratonin prirjen për një mbulim të tillë, i cili disa herë ishte mjaft diskriminues.

Metodat e përdorura disa herë për të raportuar mbi disa persona ose institucione u konsideruan të turpshme ose të pandershme nga pjesëmarrësit në këtë sondazh. Pothuajse njëzëri shembulli i përmendur këtu ishte ai i programit satirik mjaft të njohur, por edhe polemizues, “Fiks Fare.” Programi është një miks humori dhe gazetarie investigative, i cili disa herë ka pretenduar se ka arritur përmirësime praktike në jetën e qytetarëve. Megjithatë, kamerat e fshehta dhe marifete të tjera të ngjashme përdoren shpesh, gjë që vendos një pikëpyetje të madhe mbi parimet etike të përdorura, ose për mungesën e tyre. Shembujt e përmendur ishin ato të inçizimit të fshehtë të një ambasadori shqiptar, filmimi tjetër i një zyrtari të lartë të akuzuar për ngacmim seksual, etj. Ka pasur madje edhe raste të pushimit ose pezullimit të disa prej personave të prekur, gjë që dëshmon rëndësinë e shqyrtimit të çështjeve etike në lidhje me këtë problem në secilin prej rasteve. Gazetarët ishin të dyzuar ndërmjet dilemave etike për këtë problem dhe të drejtës së publikut për informacion, duke pasur parasysh ndikimin përfundimtar relativisht pozitiv të programit. Nëse shkojmë përtej rastit konkret të përmendur këtu, prirja që vihet re midis rreshtave duket se është ajo që gazetarët nuk kanë dilema të mëdha etike kur vjen puna te ndërhyrja në jetën personale, si të personave publikë, ashtu dhe të atyre jo publikë.

Ajo që e bën situatën etike më të vështirë në këto raste është numri i pakët i përgënjeshtimeve të botuar në media në këtë aspekt. Shumica e gazetarëve thanë se përgënjeshtimet ishin mjaft të rralla, si në median e tyre, ashtu dhe në të tjerat. Kishte dhe nga ata që e shtjelluan situatën më gjerë, duke thënë se në shumicën e rasteve përgënjeshtimet ishin korrigjime të gabimeve ortografike ose të disa gabimeve faktuale të parëndësishme; përgënjeshtimet që kanë të bëjnë me kuptimin e vërtetë të informacionit ishin shumë të rralla.

Gjendja duket se përmirësohet kur bëhet fjalë për trajtimin e të miturve. Shumica e gazetarëve thanë se media e tyre nuk e botonte identitetin e të miturve, me përjashtim të pak rasteve, kur ishte e domosdoshme për artikullin që të zbulohej identiteti. Megjithatë, kur vinte puna te viktimat, mendimi i tyre nuk ishte aq

tolerant në trajtimin e tyre: kishte raste të shpeshta kur pamje të përgjakshme tregoheshin ose kur identifikimi i viktimave apo i personave të prekur ishte bërë i ditur, megjithëse kjo gjë nuk ishte e nevojshme. Një aspekt tjetër i përmendur ishte ai i cilësimeve të nxituara në dënimin e personave që presin vendimin nga gjykata. Gazetarët dukej se ishin të pavendosur nëse ishte media e shkruar apo televizioni që duhej fajësuar më shumë. Përfundimi i vetëm i saktë ishte se radio nuk përmendej fare, kryesisht për shkak të natyrës teknike specifike të kësaj media.

Në përgjithësi gazetarët ranë dakord se ka ende mjaft vend për përmirësim në këtë aspekt, më saktë në pasqyrimin e gjykatave, të të paraburgosurve, viktimave, të miturve, etj. Gërshetimi i diletantizmit, titujve sensacionalë, si dhe raportimit të nxituar dhe të pakujdesshëm është një pengesë që gazetarët shqiptarë duhet të kapërcejnë sa më shpejt që të jetë e mundur. “Përsa i përket mbrojtjes së privacisë dhe të drejtave të njeriut, media shqiptare mbetet ende mjaft mbrapa.”

Ngjan se gjendja është mjaft më mirë kur bëhet fjalë për shpërndarjen e të dhënave personale të personave ose për përdorimin e personave me çrregullime fizike ose mendore si burime informacioni. Në mënyrë të ngjashme, kur raportohet për një krim, shumë gazetarë thanë se rastet e përmendjes së përkatësive fetare dhe seksuale janë mjaft të rralla për momentin, megjithëse gjendja ka qenë e ndryshme në të kaluarën. Nga ana tjetër, raportimi duket se është mjaft i ndjeshëm ndaj kombësisë, e cila përmendet gjithnjë. Në fakt, në një kohë kur raportimi mbi krimin e organizuar është bërë një detyrë e përditshme e gazetarëve shqiptarë, dhe duke pasur parasysh natyrën gjithnjë e më ndërkombëtare të kësaj teme, ky konstatim nuk duhet të na habitë. Gjithashtu nuk duhet të na habitë përmendja e përkatësive të pakicave, shpesh e përdorur në një kuptim negativ. Përfshirja e romëve, për shembull, përmendej pa asnjë përgjashtim, edhe pse shpesh nuk ishte aq e rëndësishme për lajmin.

Përsa u përket citimeve ose kujtimeve të kriminelëve, shumë gazetarë e cilësuan këtë si një temë jo shumë problematike, pasi kjo nuk ishte një dukuri e përhapur. Për më tepër, shumica këmbëngulën se edhe pse ata citoreshin, kjo bëhej për hir të balancës dhe nuk kishte implikime të tjera. Vetëm një prej tyre tha se në fund të fundit imazhi i tyre ishte përmirësuar pasi intervistat ishin botuar. Media e shkruar dukej se vuante më shumë nga ky fenomen; edhe sensacionalizmi kishte pjesën e vet të fajit në këtë aspekt. Në një frymë më pozitive, gazetarët pothuajse gjithnjë e ruanin fshehtësinë e burimeve të tyre dhe redaksitë e tyre ishin aleate në këtë drejtim.

Në përgjithësi, mund të thuhet se gazetaria ka një përparim të pamohueshëm, edhe pse të ngadaltë, në lidhje me respektin më të madh për të drejtat e njeriut në disa aspekte. Megjithatë, rruga drejt standarteve të larta etike në gazetarinë shqiptare pengohet nga ndikimi i tepruar i pronarëve të mediash dhe ndërthurja e interesave ekonomike dhe politike në fushën e medias. Kjo gjendje e ndërlikuar,

së bashku me mungesën e kontratave të punës për gazetarët dhe mungesën e një sindikata, sjell dukurinë e përhapur të vetëcensurës në komunitetin e gazetarëve. Kjo dukuri forcohet më shumë duke pasur parasysh mungesën e mekanizmave vetë-rregulluese për zbatimin e kodeve të etikës brenda komunitetit, si dhe profilin e dobët dhe të copëzuar të shoqatave të gazetarëve në vend. Në përfundim, standartet etike të gazetarisë në vend dhe misioni publik i medias, kompromentohen në mënyrë domethënëse nga interesa të tjera, në dukje më të fuqishme sesa t'i shërbesh publikut dhe të ruash integritetin profesional.